



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:199165

Datë: 09.10.2024

Numri i dokumentit: 06275342

2024:199166

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykuese Fitore Daci me bashkëpunëtoren profesionale Lavdije Brahimi-Aliu, në çështjen penale kundër të pandehurës Sh.M me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale, Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2, të KPRK-se, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.II.Nr.1060/24, të datës 12.07.2024, në praninë e Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurës SH.M, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 16.09.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me date 18.09.2024, përpiloj me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura:

SH.M, nga i ati Sh....., dhe e ëma N....., e gjinisë V....., e lindur më datë në Fshatin, Komuna - Kaçanik, me vendbanim në rrugën “.....” në fshatin ..., Komuna - Ferizaj, ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së dobët ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, me nr. personal:.....

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse:

Me datë 14.06.2024, rreth orës 13:00h, në rrugën "...", në Ferizaj saktësisht në marketin ".....", e pandehura me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka ndërmarr veprime në drejtim të kryerjes së veprës penale, në atë mënyrë që ka hyrë në marketin e lartcekur dhe nga aty ka marr - vjedhur produkte si: (ullinj të gjelbër, letër e lagur, shapona për trup, aromë fresher, gota, tablo të çajit, çorape), me ç 'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 33.62 €,-

-Me këtë veprim ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, dhe nenit 313 paragrafi 2, të KPRK-së dhe neneve 364 , 449 , 462, të KPPK-së, të pandehurën e:

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura brenda periudhës kohore prej 1 (një) viti, /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

E dëmtuara Market ".....", në rrugën "...", në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzetë euro), si dhe të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data kur Aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.Nr.1060/24, të datës 12.07.2024, e ka ngarkuar të pandehurës SH.M me vendbanim në fshatin ... Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale, vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 16.09.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin prokurori i shtetit Ismet Rrahmani, e pandehura SH.M.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar

Në shqyrtimin fillestar të datës 16.09.2024, pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurën në kuptim të nenit 241 paragrafi 1, të KPPK-së dhe pasi që e pandehura ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Pasi që gjykata është bindur se e pandehura e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, konform nenit 241 paragrafi 4, të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

E pandehura SH.M, me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar në shqyrtimin fillestar ka theksuar se: e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza, është penduar thelle, kërkon falje publike duke theksuar se veprën e ka kryer për shkak të kushteve të renda ekonomike, premtion se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, si dhe e lut gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe të më shqiptojë një dënim sa më të butë.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, Gjyqtaria e vetme gjykuese në kuptim të nenit 242 paragrafi 5, të KPPK-së, ka kërkuar që Prokurori i Shtetit të jap mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, ngase ky pranim i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 242, të KPRK-së,

pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, prandaj gjykatës i propozon që këtë pranim fajësie të e aprovoj.

Pasi që e pandehura ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 paragrafi 6, të KPPK-së, edhe përkundër paralajmërimit të të pandehurës për nenin 246 paragrafi 1, të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, si: deklarata e dëshmitares D.R e dhënë në polici, me datë 14.06.2024, deklarata e të pandehurës e dhënë në stacionin policor me datë 14.06.2024, raporti i Oficerit Policor i datës 14.06.2024, si dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lëndës dhe konstaton se Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim fillestar publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me qenë se e pandehura ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjyqtaria e vetme gjykuese konform nenit 242 paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurit

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurës ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale, kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-se, pasi që e pandehura në kohë dhe vend të caktuar si në Aktakuzë, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja e që vetit të i sjellë dobi pasurore, në marketin, në rrugën "...", në Ferizaj, ka përvetësuar disa produkte në vlerë prej 33,62 €.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70, të KPRK-së, dhe si rrethanë veçanërisht lehtësuese i mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës që në seancën e shqyrtimit fillestar, ndërsa si rrethanë lehtësuese i mori parasysh faktin se e pandehura është penduar për veprën e kryer penale dhe ka premtuar se vepra të tilla më nuk do të përsëris, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese dhe të pandehurës i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e te dëmtuarës në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Shpenzimet procedurale

Vendimi mbi shpenzimet paushallë është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 452 paragrafi 1, lidhur me nenin 449 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6, të KPPRK-së.

Vendimin për shumën për Fondin e Kompensimit të viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 paragrafi 1, 2, 3, nën paragrafi 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit 08/L-109.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:199166, datë 18.09.2024

Bashkëpunëtore Profesionale

Gjyqtarja

Lavdije Brahimi-Aliu

Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.